

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE DURRES

REP.N. 3099 Kolek. 6411



KONTRATE SHITJE

PASURI E LUAJTESHME (KUOTA SHOQERIE)

Ne Durres, sot me Tete Shtator te vitit Dymije e Gjashte (08.09.2006), e premtë para meje **Miriana PREVAZI**, Notere, e regjistruar ne Dhomen e Notereve Durres me studio ne Lagja nr.4 rruga Skenderbej, u paraqiten personalisht palet:

SHITESI : EDMOND BUJARI, i biri Xhavitit, lindur me 05.01.1955 ne Durres, banues ne Durres, L.8, rruga "14 Nentori" nr.22 , per identitetin e te cilit jam e sigurte nepermjet njohjes direkte me te, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

BLERESI :ARTUR BUJARI, i biri Xhavitit, lindur me 29.10.1956 ne Durres, banues ne Durres, L.14, rruga Tirana, per identitetin e te cilit jam e sigurte me njohje direkte me te, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet me deshire te plote e vullnet te lire me kerkuan perpilimin e kesaj kontrate shitblerje pasurie te luajteshme, ku deklaruan:

Palet jane ortake dhe bashkepronare sebashku me Giuseppe Saracino, te Shoqerise "BUNA" shpk me qender ne L.14, Shkozet, e regjistruar si person juridik me Vendim Nr.13820/3 dt.31.05.2002 te Gjykates Shkalles pare Tirane , me kapital fillestar 100.000 leke .Po me kete vendim jane vendosur dhe kuotat qe te tre ortakët zoterojne ne kete shoqeri dhe pikerisht:

Ortaku Edmond BUJARI - ne masen 55 % .

Ortaku Artur BUJARI - ne masen 23, 32 %

Ortaku Giuseppe Saracino- ne masen 21, 66 %

Me vulletin e tij te lire dhe te plote Ortaku Edmond BUJARI i shet teresisht kuotat E kapitalit qe zoteron ne kete shoqeri pra 55% per nje çmim prej **55.000 Leke ortakut Artur BUJARI**.

Bleresi deklaroi se pranon te bleje kete pasuri te luajteshme me çmimin e caktuar me siper, shume te cilen blerësi ja ka likujduar shitesit plotesisht jashte kesaj zyre. Shitesi deklaroi se ka marre nga blerësi shumen e mesiperme.

Palet moren dijeni se me lidhjen e kesaj kontrate dhe me nenshkrimin e saj nga ana e tyre, shitesi zhvishet nga e drejta e pronesise mbi kete pasuri te luajteshme dhe pronar i saj behet bleresi Artur BUJARI ne masen 78,32 % te kuotave te Shoqerise "BUNA" Shpk. Palet deklarojne se vendimi i Asamblese se ortakeve per largimin nga shoqeria "BUNA" shpk te ortakut Edmond Bujari dhe shitja e kuotave ortakut Artur Bujari do te merret me vone , mbasi ortaku Giuseppe Saracino nuk ndodhet aktualisht ne Shqiperi.

Baza legale e kontrates dhe zgjidhja e çdo konflikti mes paleve neni 705 e vijues K.C. Kontrata redaktuar ne kater kopje me te njejtin efekt ligjor, ju lexohet paleve te cilet e aprovojne dhe e nenshkruajne ne pranine time.

Une noterja vertetoj sipas ligjit n.7829 dt. 01.06.1994 "Per Noterine ne R.SH".

SHITESI

Edmond Bujari
Edmond

BLERESI

Artur Bujari
Artur

NOTERE
Miriana PREVAZI

Miriana Preva
Miriana